



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 23.10d.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMPANISË
REGJIONALE TË MBETURINAVE UNITETI SH.A MITROVICË PËR
VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave Uniteti sh.a, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme *Vlora Spanca*, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësi i ekipit *Bahri Statovci dhe anëtarja e ekipit Valbona Pllana*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Enver Boqolli*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
5 Qeverisja.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	28
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	31
Shtojca III: Letër konfirmimi	35

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave Uniteti sh.a për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 11/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar bazuar në cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave Uniteti.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Kompanisë Regjionale të Mbeturinave Uniteti për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.


Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm

Mohim i opinionit

Për shkak të mungesës së dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, ne nuk ishim në gjendje të japim opinion për PVF-të e vitit 2017.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Kryesuesi i Bordit është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Kompanisë Regjionale të Mbeturave Uniteti sh.a (tutje Kompania). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Kompanisë deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP-së).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. PFV-të përgatiten dhe nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Financiar i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KE) dhe dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Mohim i opinionit

Ne ishim angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Unitetit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.

Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për mohim të opinionit, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion për këto pasqyrat financiare.

Baza për mohim të opinionit

Ne nuk ishim në gjendje të shprehim një opinion, për arsyet e përmendura në vijim:

1. Gjendja e obligimeve të papaguara për tatim në të ardhura personale, kontribute pensionale dhe tatimi në vlerën e shtuar në bilancin e gjendjes ishin prezantuar në shumë prej 1,772,732€ ndërsa sipas ATK-së gjendja e obligimeve të papaguara për këto tatime dhe kontribute përfshirë edhe ndëshkimet për vonesa, me 31.12.2017 ishte 2,566,534€ apo 793,802€ më shumë. Kjo për shkak se kompania nuk i ka kalkuluar dhe prezantuar ndëshkimet dhe interesat ndërsa ATK-ja i ka përfshirë;
2. Sipas SNK 16, kërkohet që njëherë në 3 deri 5 vite të bëhet rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese. Vlera e pasurive jo qarkulluese (toka, objekte ndërtimore dhe pajisje & makineri) sipas PFV ishte 1,583,732€ për të cilat Kompania nuk kishte bërë asnjëherë rivlerësimin e tyre dhe nuk kishte as plan të amortizimit për jetën e përdorimit të tyre. Kompania gjithashtu nuk ka arritur

të dëshmoj se ka dokumente të pronësisë për tokat dhe ndërtesat që ishin në zotërim të sajë. Kjo për shkak të vështirësive financiare dhe kontrolleve të brendshme jo funksionale;

3. Kapitali rezervë i prezantuar në pasqyrën e ekuitetit ishte 2,394,047€. Ky kapital ishte trashëguar nga vitet e më hershme (që përfshin pasurinë të përberë nga toka, ndërtesat dhe pajisjet). Kompania nuk ka bërë ndonjë rivlerësim të saj asnjëherë dhe kjo vlerë tani mund të ishte tjetër nëse do të ishte bërë një rivlerësim i saj;
4. Parapagimet ndaj punëtorëve në PFV ishin prezantuar si llogari të arkëtueshme, kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e llogarive të arkëtueshme në bilancin e gjendjes në vlerë prej 138,693€, kjo për shkak të keq klasifikimit të parapagimeve të pagave si llogari të arkëtueshme nga punëtorët;
5. Të hyrat nga shërbimet sipas librit të shitjes ishin 1,010,054€ ndërsa sipas PFV-ve ishin 1,139,486€. Kjo ka rezultuar me mos harmonizim e të hyrave në vlerë prej 129,432€;
6. Shpenzimet tjera në PFV ishin prezantuar 606,789€, në këtë shumë janë përfshirë edhe provizionimet për borxhet e këqija në vlerë 148,573€. Shpenzimet tjera sipas PFV pa përfshirë provizionimet e borxheve të këqija ishin 458,216€ ndërsa sipas librit të blerjes ishin në vlerë 540,572€ që kanë rezultuar me diferencë për 82,356€;
7. Provizionimet për borxhet e këqija sipas bilancit provues ishin 254,658€ ndërsa në PVF ishin në vlerë 148,573€ që kanë rezultuar me nënvlerësim të shpenzimeve në PFV për 106,085€;
8. Në bilancin e gjendjes obligimet ndaj të punësuarave ishin prezantuar në vlerën 100,007€ ndërsa sipas librit kryesor ishin 130,000€ që kanë rezultuar me nënvlerësim të shpenzimeve në PFV për 30,000€;
9. Gjendja e llogarive të arkëtueshme tregtare më 31.12.2017 ishte në vlerë 2,962,981€. Ne kemi kërkuar nga Kompania që të siguroj konfirmimet nga disa klient me borxhe më të mëdha. Mirëpo, ne nuk kemi pranuar ndonjë konfirmim nga ana e tyre për shkak se kompania nuk kishte dërguar letër konfirmimet tek klientët e saj. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri për saktësinë e llogarive të arkëtueshme;
10. Gjendja e llogarive të pagueshme tregtare me 31.12.2017 ishte në vlerë 323,984€. Ne kemi kërkuar nga Kompania të siguroj konfirmimet nga disa furnitorë më të mëdhenj, mirëpo ne nuk pranuan ndonjë konfirmim nga ana e tyre për shkak se kompania nuk kishte dërguar letër konfirmimet tek furnitorët e saj. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri për saktësinë e llogarive të pagueshme;
11. Furnizimet me derivate për vitin aktual në vlerë 208,934€ ishin bërë pa kontratë. Edhe pse në planin e prokurimit ishin të planifikuara, kompania nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit për furnizim me derivate. Kjo për shkak të mos inicimit të kërkesës për blerje nga njësi kërkuese dhe për mungese të funksionimit të sistemit të kontrolleve të brendshme; dhe
12. Shënimet shpjeguese të PFV-ve janë të mangëta në prezantimin e informatave të përgjithshme, të politikave të kompanisë dhe në shënimet sqaruese për disa zëra të bilancit të gjendjes dhe të pasqyrës së rrjedhës së parësë që kishin paqartësi dhe diferenca në vlera financiare. Kjo për

shkak të mos njohjes së mjaftueshme të kërkesave të standardeve të kontabilitetit për prezantimin e shënimeve shpjeguese në PFV.

Çështje Të tjera

Pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 janë audituar nga një kompani private e auditimit, e cila kishte refuzuar të japë opinion, për shkak se kompania nuk kishte evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për auditimin e zërave të PFV-ve.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Kryesuesi i Bordit të Kompanisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit akrual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare vjetore në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi, dhe të japim një opinion të auditimit. Megjithatë, për shkak të çështjeve që janë përshkruar në paragrafin e bazës për refuzimin e opinionit, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit që të na jepte një bazë për opinionin e auditimit.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe

Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përgatisë raportet si në vijim:

- Statuti i NP-së;
- Plani i biznesit;
- Raporte tremujore;
- Raporte vjetore;
- Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në draft PFV-të ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe shënimet shpjeguese që ishin përcjellë me gabime materiale. Përkundër sugjerimeve tona për ti bërë veprimet e nevojshme, kompania kishte bërë disa korrigjime, mirëpo nuk kishte arritur ti eliminoj gabimet në tërësi. Si pasojë e kësaj ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar tek baza për opinion.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, PFV-të e përgatitura nga KE dhe ZKFTH me rastin e dorëzimit në BD, nuk mund të konsiderohen të sakta për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mos-pajtueshmëritë si në vijim:

Raportet e tre tremujorëve të parë të vitit 2017 të kompanisë përmbajnë vetëm gjendjet në fund të tremujoreve për shpenzime, faturime dhe inkasime, kështu nuk kishte arritur t'i përmbush të gjitha

kërkesat ligjore lidhur me përmbajtjen e raporteve tremujore siç e kërkon neni 31.1 i Ligjit të ndërmarrjeve publike. Respektivisht nuk përmbajnë:

- 1) një pasqyrë të strukturës organizative të NP, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë tremujorit përkatës;
- 2) një përmbledhje të gjitha procedurave gjyqësore ose që mund të përfshijnë NP-në ose që NP pritet t'i iniciojë gjatë tremujorit aktual; dhe
- 3) sugjerime dhe propozime për ndryshime të cila me arsye pritet që ta rrisin performancën e NP-së.

Ndërsa, raportin e tremujorit të fundit të vitit nuk e kishte përgatitur fare. Kjo ka ndodhur pasi që kompania kishte konsideruar si të mjaftueshme përmbajtjen e dy raporteve të tremujorëve të parë.

Sipas nenit 31.3 të Ligjit për ndërmarrjet publike, brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, zyrtarët e NP-së në përputhje me nenin 14.1 do të përgatisin dhe dorëzojnë BD të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektiviteti i përgjithshëm në realizimin e caqeve të vendosura në planin e biznesit. Brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit vjetor, BD të NP do ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e sheh të arsyeshme ta miratojë dhe ta dorëzojë, secilin raport të këtillë vjetor Komisionit Komunal të Aksionarëve. Bordi i NP-së po ashtu do ti publikojë raportet vjetore në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP. Përkundër kërkesës ligjore, Kompania nuk kishte përgatitur raportin vjetor për vitin 2017.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet për mohim të opinionit të auditimit dhe të merren të gjitha veprimet që gabimet në PVF të korrigjohen dhe të mos përsëriten.

Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, raportet tremujore, raportet vjetore. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-ës.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Kompani. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të Kompanisë ishin të dobëta. Proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit nuk janë adekuate dhe nuk janë mbështetur me rishikim të buxhetit gjatë vitit. Mos hartimi i planit të biznesit bazuar në mundësitë reale të kompanisë rrit rrezikun që në fakt këto synime mos të realizohen në periudhën përkatëse.

Kompania edhe përkundër një humbje të akumuluar nga vitet e mëparshme, në tri vitet e fundit kishte operuar me fitime. Kjo tregon se kompania ka filluar të ketë një përmirësim të gjendjes financiare edhe pse ende është në vështirësi nga humbjet e akumuluarat. Megjithatë, mos pagimi i borxheve me kohë ndaj ATK-së krijon detyrime shtesë për vonesa të pagesave dhe interesa, të cilat shkaktojnë në vazhdimësi rritje të këtyre borxheve. Vlera e lartë e llogarive të arkëtueshme të akumuluarat nga vitet paraprake rrit rrezikun e vjetërsimit dhe mos mbledhjes së tyre. Mos pagesa e pagave të rregullta mujore për disa të punësuar dhe dhënia e pagave si paradhënie për disa të tjerë krijon trajtim jo të barabartë ndaj punonjësve.

Për më shumë, punësimi i punëtorëve pa shpallje të konkursit, ka rezultuar me papajtueshmëri ligjore dhe mungesë transparence. Kjo, gjithashtu rrit rrezikun e mos përzgjedhjes së punonjësve më të mirë të mundshëm që do të ndikonin në rritjen e performacës së kompanisë.

Mos zhvillimi i aktiviteteve të planifikuara të prokurimit dhe furnizimet duke anashkaluar procedurat e prokurimit, rrisin rrezikun që shpenzimet e fondeve publike për blerje të përdoren në mënyrë joekonomike dhe joefikase, gjithashtu duke e shmangur transparencën dhe konkurrencën e tregut.

Po ashtu mos hartimi i planit të veprimit për zbatimin e çështjeve të dala nga auditimi i jashtëm tregon mos gatishmërinë e menaxhmentit për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në kompani.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga BD për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin tek Kompania.

3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit për Unitetin sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2017 (në €)

Përshkrimi	Planifikimi fillestar 2017	Plani përfundimtar 2017	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Të hyrat nga shërbimet	1,846,406	1,846,406	1,139,486	1,282,313
Të hyrat nga subvencionet dhe granatet	30,086	30,086	535,472 ¹	277,651
Gjithsej të hyrat	1,876,492	1,876,492	1,674,958	1,559,964
Shpenzimet për paga	936,649	936,649	966,933	912,072
Shpenzimet operative	860,933	860,933	691,171	589,341
Të dalat financiare	0	0	9,109	29,024
Gjithsej shpenzimet	1,797,582	1,797,582	1,667,213	1,530,437

Gjithsej shpenzimet për vitin 2017 ishin realizuar 1,667,213€ kundrejt 1,797,582€ të planifikuara apo rreth 93% e planit vjetor. Nga të dhënat e prezantuara në tabelën me lartë vërehet se dinamika e shpenzimeve të përgjithshme tregon trend të rritjes edhe këtë vit. Krahasuar me realizimin e shpenzimeve në vitin 2016, këtë vit kemi një rritje prej 136,776€ ose rreth 8%.

Të hyrat (faturimet) e përgjithshme të realizuara për vitin aktual ishin në vlerë 1,139,486€ nga 1,876,492€ të planifikuara, respektivisht rreth 61% e planit vjetor. Ndërsa arkëtimet ishin 1,029,686€.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për zërat me peshë më të lartë janë dhënë si në vijim:

- Të hyrat e realizuara nga amvisëria ishin 348,376€ nga 644,788€ të planifikuara apo 54% kundrejt planit. Krahasuar me vitin paraprak ishin realizuar 283,880€ apo rreth 44% më pak;
- Të hyrat nga bizneset ishin realizuar 255,647€ nga 374,473€ të planifikuara apo 68% kundrejt planit vjetor. Krahasuar me vitin paraprak ishin realizuar 46,552€ apo 15% më pak;
- Të hyrat nga institucionet ishin realizuar 528,969€ nga 607,354€ të planifikuara apo 87% kundrejt planit vjetor. Krahasuar me vitin paraprak ishin realizuar 181,112€ apo 52% më shumë;
- Për të hyrat nga subvencionet ishte nënshkruar marrëveshja në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe Kompanisë regjionale të mbeturinave "Uniteti". Qëllimi

¹ Në shumën 535,4732€ janë përfshirë subvencionet nga ministria e zhvillimit ekonomik në vlerë 453,342€ dhe të hyrat nga garantet qeveritare në vlerë 82,130€.

i kësaj marrëveshje ishte mbështetja financiare nga MZHE për Kompaninë për vitin 2017, në kategoritë ekonomike të subvencioneve dhe shpenzimeve kapitale. Sipas marrëveshjes MZHE do të subvencionojë mbulimin e shpenzimeve operative-inkasimin për rastet minoritare dhe pjesën në veri të Mitrovicës sipas regjistrit të konsumatorëve, brenda mundësive për mbulimin e derivateve për trajtimin e mbeturinave në deponi vetanake atëherë kur kompania është në krize financiare;

- Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve të vitit 2017 ishin në vlerë 966,933€ kundrejt 936,649€ të planifikuara duke rezultuar me rritje të shpenzimeve në vlerë 30,284€. Krahasuar me vitin 2016 shpenzimet për paga dhe mëditje ishin për 54,861€ apo rreth 6% më të larta. Këto shpenzime përfaqësojnë 58% të shpenzimeve të përgjithshme të realizuara në vitin 2017; dhe
- Shpenzimet operative për vitin 2017 ishin realizuar në vlerë prej 691,171€ nga 860,933€ të planifikuara apo 80% e tyre. Ndërsa, krahasuar me vitin paraprak ishin për 101,830€ më shumë apo rreth 15%.

Çështja 2 - Realizimi jo i duhur i planit të biznesit

- E gjetura** Në bazë të analizës që i kemi bërë planit të biznesit dhe realizimit të këtij plani, rezultoi se Kompania nuk kishte bërë analiza të mjaftueshme dhe të sakta për identifikimin e nevojave reale të saj. Në planin e biznesit ishin paraparë: pagesat e rregullta të punëtorëve për paga dhe kontribute pensionale, zvogëlimi i shpenzimeve të derivateve (shpenzimet e derivateve me të larta krahasuar me vitin paraprak 81.711€), zëvendësimi i automjeteve të vjetruara (këto investime ishin paraparë nga subvencionimi i qeverisë apo investitor tjetër), dhe investimet tjera kapitale, të cilat nuk i ka realizuar. Për më shumë, gjatë vitit 2017 nuk ishin realizuar aktivitetet e planifikuara sipas planit të prokurimit, përderisa kompania ishte furnizuar pa kontrata. Përmbajtja e këtij plani nuk reflekton mundësitë reale të kompanisë. Kjo për shkak se gjatë hartimit të planit të biznesit nuk kishte marrë parasysh sfidat buxhetore dhe nuk kishte ushtruar kontrolle të mjaftueshme gjatë përgatitjes së planit.
- Rreziku** Mos hartimi i planit të biznesit bazuar në mundësitë reale të kompanisë rritë rrezikun që në fakt këto synime mos të realizohen në periudhën përkatëse.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj hartimin e planit të biznesit duke u bazuar në mundësitë reale të kompanisë me qëllim të realizimit të synimeve afariste të sajë, dhe ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestar të reflektohen në një plan të rishikuar.

3.2 Pasqyra e pozitës financiare (Balanci i gjendjes)

Ne kemi bërë auditimin e bilancit të gjendjes, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

Tabela 2: Bilanci i gjendjes së Unitetit më 31 dhjetor 2017

në €

Pasuritë	Viti 2017	Viti 2016	Detyrimet dhe Ekuiteti	Viti 2017	Viti 2016
Paratë në bankë dhe arkë	50,488	2,652	Llogarite e pagueshme	323,985	334,671
Stoqet	7,132	7,513	Detyrimet ndaj pagave të punëtorëve	100,008	87,712
Parapagime ndaj punëtorëve	138,693	126,057	Detyrime tatimore	1,772,733	1,624,605
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	2,962,982	2,885,270	Obligime ndaj bankave	10,271	15,096
Toka	1,225,780	1,225,780	Të hyrat e shtyra	190,726	272,857
Ndërtesat	283,950	310,448	Kapitali themelues	25,000	25,000
Pajisjet	74,002	130,478	Kapitali rezerve	2,394,047	2,394,047
			Fitimi/humbja e bartur	-80,714	-110,241
			Fitimi/humbja e vitit	6,971	29,527
Gjithsej pasuritë	4,743,027	4,688,198	Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti	4,743,027	4,673,274

Çështja 3 - Mos barazim i aktives me pasiven e bilancit të gjendjes

E gjetura

Sipas SNK-ve pasiva dhe aktiva në bilancin e gjendjes duhen të jenë të barabarta. Në tabelën e bilancit të gjendjes vërehet një diferencë në vlerë 14,924€ në mes të aktives dhe pasives të vitit paraprak. Kjo nuk na japë siguri së saldot fillestare janë të sakta. Menaxhmenti i kompanisë nuk ishte në gjendje të identifikoj dhe korrigjoj gabimin e bartur nga vitet e me hershme. Kjo për shkak të kontroleve të brendshme jo funksionale në mbajtjen e regjistrave kontabël.

Rreziku

Prezantimi i bilancit të gjendjes me diferenca në mes të aktives dhe pasives i zbeh besueshmërinë ndaj pasqyrave financiare të kompanisë.

Rekomandimi 3

Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për t'i identifikuar dhe korrigjuar gabimet që kanë ndikuar në mos barazimin a aktives dhe pasives së bilancit të gjendjes, në mënyrë që PFV të prezantojnë gjendjen e saktë të kompanisë.

Çështja 4 - Trendi i rritjes së obligimeve të papaguara ndaj ATK-së

E gjetura Në vitet e fundit kishte rritje të borxheve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) si pasojë e mos pagesës së obligimeve ndaj ATK-së nga vitet paraprake për të punësuarit në kompani. Gjithsej obligimet e papaguara përfshirë edhe TVSH deri në fund të vitit 2017 ishin si në vijim:

- Obligimet e papaguara për kontribute, ndaj ATK-së deri më 31.12.2017 ishte 1,365,202€ nga kjo shumë 105,969€ ishin për vitin 2017. Sipas Ligjit nr. 4/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, (nenit 6.3) Punëdhënësi zbrit kontributin pensional të punonjësve nga rrogat e punonjësve dhe e bartë në llogarinë e posaçme të fondit bashkë me kontributin e punëdhënësit në afatin e duhur në përputhje me rregullat e ATK-së;
- Obligimet e papaguara për tatimin në burim deri në fund të vitit 2017 ishin 471,166€ nga kjo shumë 40,658€ ishin për vitin 2017. Sipas nenit 6 të Ligjit nr. 05/L-028 për tatim në të ardhura personale, secili punëdhënës është përgjegjës të mbajë në burim tatimin nga pagat e tatueshme të paguara të punëtorëve të tij;
- Obligimet e papaguara për TVSH deri në fund të vitit 2017 ishin 646,994€ nga kjo shumë 20,355€ ishin për vitin 2017; dhe
- Obligimet nga deklaratimet vjetore deri në fund të vitit 2017 ishin 83,170€ nga kjo shumë 830€ ishin për vitin 2017.

Faktor kryesor që ka ndikuar në rritjen e obligimeve (borxhit) ndaj ATK-së ishte gjendja jo e mirë financiare e kompanisë.

Rreziku Mos pagimi i borxheve me kohë ndaj ATK krijon detyrime shtesë për vonesa të pagesave dhe interesa, të cilat shkaktojnë në vazhdimësi rritje të këtyre borxheve.

Rekomandimi 4 Kryesuesi i Bordit duhet të marr masat e menjëhershme për shlyerjen e obligimeve ndaj ATK dhe sipas nevojës të hyjë në marrëveshje për programimin e shlyerjes së këtyre borxheve.

Çështja 5 - Trend rritës i llogarive të arkëtueshme

- E gjetura** Bazuar në të dhënat e prezantuara në PVF vërehet trendi në rritje i llogarive të arkëtueshme. Në vitin aktual ishin 3,101,674€ krahasuar me vitin paraprak llogaritë e arkëtueshme ishin rritur për 90,347€ apo 3%. Kjo për shkak të menaxhimit jo adekuat të tyre dhe mos ndërmarrjes së të gjitha procedurave të mundshme për arkëtimin e tyre.
- Rreziku** Vlera e lartë e llogarive të arkëtueshme të akumuluar nga vitet paraprake rritë rrezikun e vjetërsimit dhe mos mbledhjes së tyre.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marr të gjitha masat e mundshme ligjore për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme në afatin me të shpejt të mundshëm.

3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Kompania në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2017 në €

Përshkrimi	Viti 2017	Viti 2016
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	1,139,486	1,282,314
Të hyrat nga granti	535,472	277,651
Gjithsejtë të hyrat	1,674,958	1,559,965
Pagat dhe mëditje	966,933	912,072
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	84,381	165,153
Shpenzimet tjera operative	606,790	424,188
Të dalat financiare	9,109	29,024
Gjithsejtë shpenzimet	1,667,213	1,530,437
Fitimi/Humbja para tatimit	7,745	29,527
Tatimi në fitim	774	0 ²
Fitimi/Humbja neto	6,971	29,527

² Sipas Ligjit 05/L-29 për tatimin në të ardhurat e korporatave, neni 23 humbjet tatimore, Shuma e humbjes tatimore e përcaktuar sipas këtij neni, mund të bartet deri në gjashtë (6) vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

Çështja 6 - Punësime pa shpallje të konkursit

- E gjetura** Sipas nenit 8 të Ligjit të Punës, çdo punëdhënës në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punonjës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Vetëm gjatë vitit 2017, kompania kishte pranuar 20 punëtor, prej tyre 10 janë për pune dhe detyra specifike me kohëzgjatje tre mujore (punëtor fizik), ndërsa 10 të tjerë janë për pozita të rregullta (zyrtar të burimeve njerëzore, mbikëqyrës në shërbimin operativ, menaxher transporti, vozitës) pa shpallje të konkursit publik. Kjo për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme menaxheriale dhe në njësinë e burimeve njerëzore.
- Rreziku** Punësimi i punëtorëve pa shpallje të konkursit, krijon papajtueshmëri ligjore dhe mungesë transparence gjithashtu rritë rrezikun e mos përzgjedhjes së punonjësve më të mirë të mundshëm që do të ndikonin në rritjen e performances së kompanisë.
- Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e procedurave të rekrutimit përmes shpalljeve të konkurseve për pranimin e punëtorëve në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e ligjit të punës.

Çështja 7 - Vonesa të pagesës së pagave për disa punonjës dhe paradhënie për pagat të disa punonjësve tjerë

- E gjetura** Nga shqyrtimi i dokumentacionit kemi identifikuar pagesa të konsiderueshme si paradhënie për paga për një numër të punonjësve gjatë vitit 2017 në shumë të përgjithshme prej 138,693€. Ndërsa, nga ana tjetër menaxhmenti i kompanisë nuk kishte arritur t'i paguaj rregullisht pagat e një pjese të punëtorëve. Vonesat për pagimin e pagave ishin për disa muaj, po ashtu pagat ishin paguar pa aprovim për pagesë nga Kryeshefi i kompanisë. Kjo për shkak të menaxhimit dhe kontrolleve të brendshme të dobëta.
- Rreziku** Mos pagesa e pagave të rregullta mujore për disa të punësuar dhe dhënia e pagave si paradhënie për disa të tjerë krijon trajtim jo të barabartë ndaj punonjësve. Pagesa e pagave pa aprovim për pagesë nga zyrtaret kompetent rrit rrezikun e gabimeve dhe keqpërdorimeve. Kjo mënyrë e menaxhimit e të punësuarve rrit rrezikun për performance të dobët dhe ballafaqim me situata të procedurave ankimore dhe ndëshkuese ndaj kompanisë.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj funksionimin dhe rregullimin e sistemit për pagat e punonjësve duke krijuar një trajtim të njëjtë ndaj të gjithë punonjësve. Po ashtu, të ndërmer masa për realizimin e pagave mujore me kohë për të gjithë punonjësit dhe që aprovohen nga zyrtaret kompetent. Gjithashtu, të ndalet praktika e paradhënies së pagave ndaj punonjësve.
-

Çështja 8 - Furnizime pa procedura të prokurimit dhe mos realizimi i planit të prokurimit

E gjetura Ndërmarrjet Publike me rastin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve kanë për obligim që të respektojnë të gjitha procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Kompania kishte përgatitur planin e prokurimit për vitin 2017. Në këtë plan kishte paraparë 23 aktivitete të prokurimit me vlerë të parashikuar 733,039€. Ndërsa, gjatë vitit 2017, ishin nënshkruar vetëm 6 kontrata në vlerë të përbashkët prej 19,025€. Ne kemi vërejtur që kompania nuk kishte respektuar procedurat e prokurimit me rastin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit aktual. Kompania kishte vazhduar të furnizohet me kripë industrial për mirëmbajtjen e rrugëve me çmim për njësi 85€, totali i furnizimeve për këtë kontratë bëhet varësisht prej kërkesës prej 25,000€ deri në 30,000€.

Këto veprime nuk janë në pajtueshmëri me nenin 4.2 të LPP. Zbatimi i prituri i procedurave të prokurimit nuk ishte arritur për shkak të mungesës së funksionimit të duhur të kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjes efektive nga menaxhmenti për furnizimet që kërkojnë procedura të prokurimit.

Rreziku Mos zhvillimi i aktiviteteve të planifikuara të prokurimit dhe furnizimet duke anashkaluar procedurat e prokurimit, rritë rrezikun që shpenzimet e fondeve publike për blerje të përdoren në mënyrë joekonomike dhe joefikase, gjithashtu duke e shmangur transparencën dhe konkurrencën e tregut.

Rekomandimi 8 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që shpenzimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve bëhen në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e LPP-së për të arritur shfrytëzimin efikas dhe transparent të parasë publike, si dhe realizimin e aktiviteteve sipas planit të prokurimit, për përmbushjen e nevojave dhe obligimeve të kompanisë.

3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të kompanisë, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Tabela 4: Kapitali i kompanisë regionale të mbeturinave Uniteti më 31.12.2017 në €

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
KAPITALI	2,345,304	2,338,333
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Kapitali rezervë	2,394,047	2,394,047
Fitimet/Humbjet e bartura	80,714	110,241
Fitimet/Humbja e vitit aktual	6,971	29,527

Në tabelën e mësipërme vërehet se kompania edhe përkundër një humbje të akumuluar nga vitet e mëparshme, në dy vitet e fundit kishte operuar me fitime. Kjo tregon se kompania ka filluar të ketë një përmirësim të gjendjes financiare edhe pse ende është në vështirësi nga humbjet e akumuluar.

Mangësitë lidhur me mos rivlerësimin e kapitalit rezerve janë prezantuar tek baza për opinion.

3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve afariste, financiare dhe investimit. Informatat rreth rrjedhës së parave të kompanisë janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Paratë neto nga aktivitetet operative	49,645	-8,647
Arkëtimet e parasë nga blerësit	1,029,686	1,074,986
Arkëtime tjera nga aktiviteti operativ (subvencione)	453,342	183,109
Pagesat për të punësuarit	-857,780	-818,851
Pagesat për furnitorët	-566,494	-417,367
Pagesat tjera (taksa, provizione bankare, tatime)	-6,207	-14,982
Pagesa për interesa	-2,901	-15,541
Paratë neto nga aktivitetet investive	-	-
Rritja e parasë	-	-
Zvogëlimi i parasë	-	-
Paratë neto nga aktivitetet financuese	-	10,000
Rritja e parasë	-	10,000
Zvogëlimi i parasë	-	-
Neto rritja / (zvogëlimi) i parasë dhe ekuivalentëve të saj	49,645	1,353
Paraja në fillim të vitit 2017	2,652	1,299
Paraja në fund të vitit 2017	52,296	2,652

Çështja 9 – Rrjedha e parasë e prezantuar me gabime

E gjetura	Kompania vlerën e parave në fund të periudhës në këtë pasqyre e ka prezantuar 52,296€ që është e mbivlerësuar për 1,808€ e cila është dashtë të jetë 50,488€ siç është prezantuar në bilancin e gjendjes. Kjo për shkak të mungesës së kujdesit të duhur dhe kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme.
Rreziku	Mos prezantimi i saktë i rrjedhës së parasë së gatshme duke e mbivlerësuar vlerën e parave ndikon në mos prezantimin e drejtë dhe të saktë të PFV-ve.
Rekomandimi 9	Kryesuesin e Bordit të siguroj që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të përgatitur dhe prezantuar të gjitha vlerat e sakta dhe të strukturuar sipas kërkesave të SNK.

3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në Bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Çështja 10 – Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese

E gjetura	<p>Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet ose pasqyrën e rrjedhës së parasë, duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese. Gjatë analizimit të shënimeve shpjeguese janë identifikuar dobësitë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk ishin prezantuar informacionet e përgjithshme të kompanisë, siç janë: koha, vendi dhe baza ligjore e themelimit, aktivitetin kryesorë të saj, adresën, llojin e valutës që e përdorë, në pronësi të kujt është kompania, etj.; • Nuk kishte prezantuar se cilën bazën të standardeve të raportimit financiar e ka aplikuar dhe përshtatur për mënyrën e njohjes së të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve e zërave tjerë në PFV-ve; • Nuk ka prezantuar politikat e rëndësishme kontabël të kompanisë, se si i njuh efektet e transaksioneve me valuta të huaja, të pasurive të prekshme dhe të pa prekshme, çfarë metodash dhe normave të zhvlerësimit përdorë, si i njuh të hyrat, të hyrat e shtyra, kur dhe si i njuh provizionet, etj.;
------------------	--

- Nuk janë prezantuar vlerat e njëjta për obligimet dhe kontribute në pasqyrën e bilancit të gjendjes që ishte 1,772,732€ me ato të shënimeve shpjeguese që ishte 1,767,605€;
- Nuk ishin prezantuar informacione lidhur me detyrimet/pasuritë kontigjente edhe pse ekzistojnë raste gjyqësore dhe të procedurave nga përmbauesit privat; dhe
- Mospërputhjeve në mes të shënimeve shpjeguese dhe të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraqesin një prezantimi jo të plotë të PFV sipas kërkesave të standardeve.

Këto kanë ndodhur shkakun e mungesës së njohurive të SNK-ve dhe funksionimit të sistemit të kontrolleve të brendshme për identifikimin e gabimeve me kohë për korrigjimet e nevojshme.

Rreziku

Prezantimi jo i plotë dhe mangësitë e informacioneve në shënimet shpjeguese, ndikojnë në cilësinë e pasqyrave financiare, paqartësinë e shifrave të prezantuara si dhe kufizojnë përdoruesit e pasqyrave për ta kuptuar gjendjen e drejtë dhe të vërtetë të rezultateve financiare dhe afariste të kompanisë.

Rekomandimi 10

Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve të prezantohen në shënimet shpjeguese informacionet e mjaftueshme për kompaninë dhe politikën e saj, përfshirë shënime të plota dhe të sakta për secilin zë të pasqyrave financiare, duke i eliminuar të gjitha diferencat e shënimeve shpjeguese me shumatat e prezantuara në pasqyrën e rrjedhës së parasë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit të jashtëm për PFV-të e vitit 2016 të Kompanisë është kryer nga një kompani private e auditimit që kishte rezultuar me refuzim të opinionit. Kjo për arsyet e mungesë së dëshmive të përshtatshme për të mbështetur vlerat e zërave në PFV-të e vitit 2016

Auditori i jashtëm nuk kishte dorëzuar Letër Menaxhmentin me rekomandime për auditimet e viteve 2015 dhe 2016 tek Kompania, për shkak se kompania nuk kishte kryer obligimet e pagesës për këto auditime. Në mungesë të Letër menaxhmentit nga auditori paraparak ishte e pamundur të vlerësojmë zbatimin e rekomandimeve për çështje të tjera.

Kompania nuk ka ndërmarr asnjë masë për të përmirësuar cilësinë e PFV-ve, për të eliminuar dobësitë që kishin ndikuar në bazën për refuzim të opinionit.

Për një përshkrim më të plotë se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 11 - Mos adresim i çështjeve të dala nga viti paraparak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, të gjitha çështjet që kanë ndikuar te baza për opinion për PFV e vitit 2017 nuk kishte arritur të zbatohen deri në prill 2018. Për më shumë, menaxhmenti i kompanisë nuk kishte përgatitur plan të veprimit për zbatimin e çështjeve të dala nga auditimi i jashtëm.

Rreziku Mos adresimi i çështjeve nga vitet paraprake rrit rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta të cilat ndërlidhen me PFV dhe me kontrollet e brendshme. Po ashtu mos hartimi i planit të veprimit për zbatimin e çështjeve të dala nga auditimi i jashtëm tregon mos gatishmërinë e menaxhmentit për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në kompani.

Rekomandimi 11 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që është përgatitur plani i veprimit për adresimin e çështjeve, i cili i përcakton veprimet, afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e planit të veprimit.

5 Qeverisja

Hyrje

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët në kompani kanë reduktuar efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.

Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes siç është Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ishte në funksion. Mos funksionimi i NJAB-së rritë rrezikun që për shkak të kompleksitetit dhe madhësisë së kompanisë, menaxheret e lartë të kanë vështirësi të kontrollojnë proceset dhe veprimtarinë e saj në mënyrë efektive. Kjo mund të rezultojë me dobësi të pidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që mund të përfundojnë me humbje financiare për kompaninë.

Mungesa e zyrtarit certifikues redukton nivelin e sigurisë së sistemit të kontrollit në realizimin e pagesave dhe rritë rrezikun e pagesave në mënyrë jo të rregullt dhe me gabime. Mos krijimi i ueb-faqes së kompanisë për publikimin e raporteve dhe rregulloreve të ndryshme të saj në ueb-faqe të internetin kufizon qasjen e publikut në informata të rëndësishme duke shkaktuar mungesë të transparencës.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshme është një aktivitet i pavarur për të ofruar siguri objektive dhe një aktivitet këshillues, i dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e kompanisë. Auditimi i brendshëm ndihmon kompaninë për përmbushjen e objektivave, duke nxitur një qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit në menaxhimin e rrezikut, kontrolleve dhe proceseve të qeverisjes.

Çështja 12 - Mos funksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

- E gjetura** Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në Uniteti nuk ishte funksionale që nga viti 2014 pasi që Kompania nuk ka arritur ta plotësoj pozitën e auditorit të brendshëm. Kompania gjatë vitit 2017 kishte shpallur tri herë konkurs për plotësimin e pozitës për auditor të brendshëm, dhe në mungesë të kandidatëve të kualifikuar sipas kërkesave të konkursit nuk ka arritur të plotësoj këtë pozitë. Mos funksionalizimi i NJAB ulë nivelin e sigurisë që i ofrohet menaxhmentit për funksionimin e kontrollit të brendshëm në kuadër të kompanisë. Kjo mund të rezultojë me çështje të pidentifikuara që kanë ndikime në menaxhimin e fondeve dhe pasurive të kompanisë.
- Rreziku** Mos funksionimi i NJAB-së rritë rrezikun që për shkak të kompleksitetit dhe madhësisë së kompanisë menaxheret e lartë të kanë vështirësi të kontrollojnë proceset dhe veprimtarinë e saj në mënyrë efektive. Kjo mund të rezultojë me dobësi të pidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që mund të përfundojnë me humbje financiare për Kompaninë.
- Rekomandimi 12** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj funksionimin e kompanisë në mënyrë efektive dhe për këtë duhet ta themelojë dhe ta vë në funksion NJAB sipas përcaktimeve ligjore, për të ndihmuar menaxhimin në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të kompanisë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj të gjitha problemeve operative të identifikuara.

Çështja 13 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rreziqeve

- E gjetura** Si pasojë e kontrolleve të dobëta menaxheriale, disa nga objektivat e planit nuk janë arritur. Procedurat e prokurimit të filluara me vonesë dhe jashtë planit, vlerësimi i dobët i nevojave, mbikëqyrja e pamjaftueshme, ndarje e detyrave jo e mjaftueshme, mos rivlerësimi i pasurive dhe mungesa e planit të amortizimit të pasurive, mos faturimi për minoritete nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Kompania, gjithashtu, nuk posedon ndonjë regjistër që identifikon rreziqet e ndryshme që mund t'i kërcënojnë aktivitetet e saj. Këto kanë ndodhur shkakut i llogaridhënies dhe kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme.
- Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.
- Rekomandimi 13** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, duhet të hartoj një plan i cili do të identifikoj të gjitha rreziqet e mundshme, të vlerësoj ndikim e tyre në rast se ato ndodhin, si dhe të përcaktoj masat parandaluese dhe ato të mëvonshme si përgjigje ndaj tyre.

Çështja 14 - Ndarje jo e duhur e detyrave - mungesë e zyrtarit certifikues

E gjetura Sipas nenit 14 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ndërmarrja publike duhet të ketë zyrtarin certifikues. Zyrtari certifikues është përgjegjës të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike janë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës. Kompania nuk kishte caktuar zyrtar certifikues për autorizimin e pagesave dhe në mungesë të tij aprovimin e pagesave e kishte bërë Kryeshefi ekzekutiv. Mungesa e zyrtarit certifikues ka rezultuar me dobësi në menaxhimin e shpenzimeve.

Kontrollet menaxheriale të zbatuara në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm nuk kanë identifikuar delegim dhe ndarje të duhur të detyrave.

Rreziku Mungesa e zyrtarit certifikues redukton nivelin e sigurisë së sistemit të kontrollit në realizimin e pagesave dhe rritë rrezikun e pagesave në mënyrë jo të rregullt dhe me gabime.

Rekomandimi 14 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj marrjen e masave të nevojshme për plotësimin e pozitës me zyrtar certifikues konform kërkesave ligjore dhe ndarje të duhur të detyrave. Kjo duhet të bëhet për të forcuar sistemin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e parasë publike.

Çështja 15 - Mos funksionalizimi i ueb faqes së internetit të kompanisë për publikimin e rregulloreve dhe dokumenteve të saj

E gjetura Neni 34.2 i Ligjit për ndërmarrjet publike, kërkon që një kopje e plotë dhe aktuale e të gjitha rregulloreve të NP-së të publikohen dhe mbahen në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP-ja. Gjithashtu, kërkohen të publikohet plani i biznesit, raportet tre mujore, raportet vjetore dhe informata tjera të rëndësishme për publikun. Kompania ende (deri në përfundimit të auditimit prill 2018) nuk kishte një ueb-faqe funksionale për publikim e informatave – raporteve për aktivitet e kompanisë që është e obliguar me ligj e ndërmarrjeve publike dhe statutin e kompanisë.

Rreziku Mos krijimi i ueb-faqes së kompanisë për publikimin e raporteve të ndryshme të kompanisë në faqe të internetin kufizon qasjen e publikut në informata të rëndësishme të kompanisë për shkak të mungesës së transparencës.

Rekomandimi 15 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj funksionalizimin e ueb-fazës së internetit të kompanisë dhe të bëjë publike të gjitha rregulloret, raportet dhe dokumentet që i kërkon ligji i ndërmarrjeve publike dhe statuti i kompanisë, për qëllime të transparencës ndaj publikut.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpalosur në shënimin 2 të pasqyrave financiare përcjellëse, me 31 dhjetor 2015 përfshirë në totalin e të arkëtueshmeve tregtare është 2,245,374€ (31 dhjetor 2014); dhe 2,625,279 me 31 dhjetor 2015 neto nga provizionet për borxhet e këqija dhe të dyshimta në vlerë prej 2,021,729€. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të vërtetojmë nëse kompania do të jetë në gjendje të inkasoje vlerën e llogarive të arkëtueshme të prezantuara, kompania nuk ka analiza të mjaftueshme të cilat mbështesin parashikimet e menaxhimentit të bëra në relacion me saldon e provizionit të borxheve të këqija dhe të dyshimta, prandaj ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse të të arkëtueshmeve tregtare të kompanisë me 31.12.2015.			Nuk është zbatuar.
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpalosur në shënimin 10 të pasqyrave financiare përcjellëse kompania ka prezantua të pagueshme tregtar me 31.12.2014 vlerën 200,029€ dhe më 31.12.2015 vlerën 252,581€, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit ne nuk ishim në gjendje të posedojmë dëshmi të mjaftueshme në vlerën kontabël.			Nuk është zbatuar

Pasqyra Financiare Baza për opinion	Kompania nuk ka kalkuluar shpenzimet e tatimit në fitim dhe gjithashtu nuk ka njohur ndonjë aset apo detyrim të tatimit të shtyrë dhe në të njëjtën kohë as shpenzim apo fitim të tatimit të shtyrë në pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015 ashtu siç kërkohet me standardin ndërkombëtarë të kontabilitetit numër 12 "tatimet në të ardhura". Në mungesë të procedurave alternative të auditimit ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nivelin e korigjimeve, nëse do kishte pasur, të cilat do të kishin qenë të nevojshme me qëllim të regjistrimit të tatimeve në përputhje me standardin Ndërkombëtar të kontabilitetit numër 12 "tatimet në të ardhura".			Nuk është zbatuar
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Mungesat në shpalosje, Pasqyrat financiare përcjellëse nuk përmbajnë të gjitha shpalosjet që kërkohen me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar SNRF 7 shpalosjet dhe instrumenteve Financiare dhe shpalosje tjera për humbje teknike.			Nuk është zbatuar
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Ne nuk ishim të kënaqur me mjete alternative në lidhje me sasinë e inventarit, dhe mjeteve themelore të mbajtura me 31 dhjetor 2016, të cilat janë deklaruar në deklaratat e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2016. Për më tepër kompania nuk ka titull pronësie për tokat dhe ndërtesat që janë në zotërim të kompanisë më 31 dhjetor 2016.			Nuk është zbatuar
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Kompania ka njohur një rezerve prej 2,394,048€ më 31 dhjetor 2015 që është njohur si diferenca në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitali fillestar të kontribuar nga aksionaret e kompanisë. Ne nuk kemi pasur mundësi të vlerësoj se rezerva e krijuar është matur, njohur dhe shpalosur në pasqyra financiare të shoqërisë në bazë të kërkesave që dalin nga SNRK 13.			Nuk është zbatuar

Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpalosur në shënimin 7 të pasqyrave financiare përcjellëse, nga total të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera të kompanisë, bilanci i të arkëtueshmeve tregtare me 31 dhjetor 2016 është 4,938,023€ neto nga provizionet për borxhe të këqija dhe të dyshimta në vlerë prej 2,052,753€. Ne e kishim të pamundur që të kemi evidence të mjaftueshme të llogarive të arkëtueshme nga shërbimet, për me tepër ishte e pamundur të kemi verifikim nga palët e treta, për me tepër ne nuk ishim në gjendje për të vlerësuar nëse do të kishte qenë e nevojshme provizionim shtesë në llogaritë të arkëtueshme dhe në çfarë niveli si pasoje e mungesës së informacionit adekuat. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të vërtetojmë nëse kompania do të jetë në gjendje të inkasoje vlerën e llogarive të arkëtueshme të prezentuara, duke marrë parasysh Ligjin Nr. 05/L-043, për faljen e borxheve publike.			Nuk është zbatuar
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Kompania nuk ka analiza të mjaftueshme të cilat mbështesin parashikimet e menaxhmentit të bëra në relacion me balancën e provizionit të borxheve të këqija dhe të dyshimta. Prandaj ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare të kompanisë me 31.12.2016.			Nuk është zbatuar
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Siç është shpalosur në shënimin 12 të pasqyrave financiare përcjellëse më 31 dhjetor 2016 përfshire në totalin e të pagueshmeve ndaj tatimeve prej 1,624,605€. Këto blanca lidhen me tatimin mbi vlerën e shtuar, kontributet pensionale, tatimi në të ardhura personale. Si rrjedhoje e mos pagesës me kohe, kompania mund të jetë subjekt i ndëshkimeve dhe kamatave shtesë të shqiptuara nga autoritet tatimore të cilat kompania nuk i ka njohur në librat e saj. Siç është shpalosur në pasqyrat financiare përcjellëse, librat dhe regjistrimet tatimore të kompanisë nuk janë audituar nga autoritet tatimore për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016. Si rrjedhoje detyrimet tatimore të Kompanisë mund të ndryshojnë për taksat shtesë dhe gjokat nëse ka ndonjë.			Nuk është zbatuar

Pasqyra Financiare Baza për opinion	Kompania nuk ka kalkuluar shpenzimet e tatimit në fitim dhe gjithashtu nuk ka njohur ndonjë aset apo detyrim të tatimit të shtyre dhe në të njëjtën kohë as shpenzim apo fitim të tatimit të shtyrë në pasqyrat e saj financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016 ashtu siç kërkohet nga standardet ndërkombëtarë të raportimit financiar. Ne mungese të procedurave alternative të auditimit ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nivelin e korigjimeve, nëse ka pasur, të cilat do të kishin qenë të nevojshme me qëllime të regjistrimit të tatimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.			Nuk është zbatuar
Pasqyra Financiare Baza për opinion	Kompania ka akumuluar detyrime të mëdha tatimore dhe detyrime tjera dhe mungesa e likuiditetit si rezultat i nivelit shumë të ulët të arkëtimeve ka bërë që kompania të mos arrije të paguaj detyrimet e saj me kohë, dhe si pasoje e kësaj është bërë dhe grumbullimi i borxheve në vazhdimësi. Pa mundësia e mbledhjes së borxheve duke u vonuar me shumë se 12 muaj në mbledhje të borxheve, dhe si rezultat i këtyre faktorëve mund të shkaktoje vështirësi financiare që mund të bëjnë që kompania të mos operojë sipas parimit të vijimësisë.			Nuk është zbatuar

Shtojca III: Letër konfirmimi

KOMPANIA REGIONALE
E MBETURINAVE "UNITETI"-SH.A.
Nr. Pror: 186
Data: 08.06.2018.
MITROVICË

Uniteti

Kompania Regionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A, Mitrovicë

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të NPKompania Rajonale e Mbeturinave UnitetiSh.A. Mitrovicë, për vitin 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Remzi Ahmeti
Kryesuesi i Bordit
Data: 08/06/2018 Prishtinë,

